



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I LËVIZJES SOCIALISTE PËR INTEGRIM



*Shëruant të  
seducave.*

Nr. Prot \_\_\_\_\_

Tiranë, më \_\_\_\_\_

**Drejtuar:** Z. Ilir Meta

Kryetar i Kuvendit

**Lënda :** Paraqitje amendamenti

Në mbështetje të nenit 71 të Rregullores së Kuvendit, të projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, propozohet që në nenin 3, i cili ndryshon nenin 48 duke shtuar nenin 48/1, pas pikes 2 të nenit të ndryshuar shtohet pika 3 e formuluar si më poshtë:

" Pika 3.

Organizatave të shoqërisë civile kanë të drejtën e monitorimit në pikat doganore të caktuara për kontrollin dhe zhdoganimin e mbetjeve.

Ato paraqesin kërkesë me shkrim për pajisjen me autorizimin nga ministri përgjegjës për mjedisin, që lejon kryerjen e këtij monitorimi.

Drejtuesit e pikave doganore kanë detyrimin e lejimit të kryerjes së monitorimit pa kufizim. "

## RELACION

Pas shqyrtimit të amendamenteve të bëra në ligjin "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve, me nr. 10 463, datë 22.9.2011", konstatova se ndryshimet synojnë një rregullim dhe përmirësim të kuadrit ligjor në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Qëllimi i ndryshimeve të propozuara në ligj, të cilat po shqyrtohen nga Parlamenti, është importimi i mbetjeve të ngurta jo të rrezikshme të listës së gjelbër si lëndë e parë dytësore, për të plotësuar nevojat e industrisë ricikluese të vendit, për qëllime riciklimi dhe përdorimi si zëvendësues të lëndëve të tjera nga burime jo të rinovueshme, që përdoren nga industria.

Ndryshimet e propozuara janë shoqëruar nga një debat i gjerë publik ku mosbesimi është i forte dhe i dukshëm. Një klimë e tillë mosbesimi besoj se mund të gjente zgjidhjen e saj më të mire duke i mundësuar opinionit dhe veçanërisht shoqërisë civile si mënyra e organizimit të pavarur qytetar, që ajo të ishte aktive në procesin e monitorimit pasi është një fakt i njohur që debati për çështjen e importit të mbetjeve është debat që zhvillohet prej disa vitesh.

**Amendamenti** që propozoj dhe që konsiston në shtimin e pikes 3, në ndryshimet e propozuara, i jep mundësi konkrete shoqërisë civile që të ketë rol aktiv në këtë proces, gjë që do të rrisë besimin në zbatimin korrekt të ligjit në praktikë, i cili është edhe qëllimi kryesor i të gjithë shoqërisë shqiptare për këtë çështje.

Ky **amendament** që propozohet duke shtuar këtë pike 3 krijon dhe një raport të ri bashkëpunimi me shoqërinë civile, i cili shëndosh raportet mes parlamentit, ekzekutivit dhe opinionit public nga ana tjetër, pasi vetëm transparenca, e cila është edhe thelbi i amendamentit të propozuar nga unë me shtimin e pikes 3, është kontributi më i mire për këtë raport, i cili duhet të priret gjithmonë nga konstruktiviteti që zgjidh problemet dhe përmirëson zbatimin praktik të legjislacionit.

Lutem në marrjen në konsideratë të kësaj kërkesë.

Deputeti propozues

PETRIT VASILJ